



**ORTEKU NË ARSIMIN E LARTË:
STUDIMET E DOKTORATËS NË SHKENCAT
SOCIALE DHE HUMANISTIKE NË UNIVERSITETIN E
PRISHTINËS**

Punim për Politika

Qershor 2018



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Ky botim është pjesë e projektit “Orteku në Arsimin e Lartë: Studimet e Doktoratës në Shkencat Sociale dhe Humanistike në Universitetin e Prishtinës” dhe është realizuar me përkrahjen e projektit *Promovimi i Shoqërisë Demokratike* (DSP) i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe e Qendrës për Kurajo Politike (CPC), dhe kursesi nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA apo i KCSF-së.

Përgatitur nga: Mentor Agani

Editorë: Lulzim Peci dhe Arben Hajrullahu

Asistente hulumtuese: Lirije Palushi

Copyright © 2018, KIPRED & CPC. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org dhe: info@cpc-ks.org

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Shqyrtimi i kriterëve të pranimit në studimet e doktoratës	7
3. Shqyrtimi i cilësisë së studimeve të doktoratës	10
4. Shqyrtimi i resurseve hulumtuese dhe i administrimit të tyre	14
5. Konkluzionet dhe rekomandimet	18

1. HYRJE

Qëllimi kryesor i projektit hulumtues “Orteku në Arsimin e Lartë: Studimet e Doktoratës në Shkencat Sociale dhe Humanistike në Universitetin e Prishtinës” është nxitja e debateve përmbajtësore dhe ndryshimi i politikave për llogaridhënien publike, qeverisjen dhe cilësinë e studimeve të doktoratës në shkencat shoqërore dhe humanistike në Universitetin e Prishtinës (UP).

Fusha e studimeve të doktoratës është ndër temat më komplekse, më diskutabile dhe, deri vonë, më të shpërfillura nga UP, Qeveria, Kuvendi dhe agjencitë përkatëse qeveritare. Ky projekt synon që këtë problematikë ta vendos në qendër të vëmendjes së këtyre institucioneve dhe të opinionit publik nëpërmjet ndikimit të shoqërisë civile në politikëbërje, dhe atë përmes: Analizës dhe gjetjes së problemeve dhe vështirësive kryesore si dhe dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e tyre në fushën e studimeve të doktoratës në UP; Përmirësimit të politikave të qeverisjes dhe administrimit të programeve të doktoratës; Rritjes së llogaridhënies institucionale; Ndërtimit të mekanizmave për kontrollimin e cilësisë dhe plagjiarizmit, si dhe; Përfshirjes së hisedarëve kyç në debatin për nevojën e përmirësimit substancial të cilësisë së arsimit të lartë.

Titulli i projektit ka buruar nga ideja që përmirësimi i cilësisë dhe ngritja e integritetit akademik në studimet e doktoratës mund ta kenë efektin e ortekut në përmirësimin e cilësisë edhe në nivelet më të ulëta të arsimit të lartë, përmes vendosjes së standardeve të larta të studimeve dhe rritjes me ritëm më të shpejtë të nivelit të dijes dhe shkencës që prodhohet në Kosovë, si dhe përmes ndërkombëtarizimit të tyre.

Në dy punimet paraprake në kuadër të këtij projekti hulumtues janë trajtuar studimet e doktoratës në katër fakultete të UP-së ku studiohen shkencat sociale dhe humanistike, dhe atë në: Fakultetin Ekonomik; Fakultetin Juridik; Fakultetin e Edukimit; dhe Fakultetin Filozofik. Në këto punime është bërë përpjekje për identifikimin e problemeve kyçe të studimeve të doktoratës në njësitë përkatëse akademike, si dhe janë diskutuar një numër çështjesh relevante. Këtu po i ritheksojmë vetëm disa nga çështjet më të rëndësishme nga dy punimet e

kaluara, e që do të jenë edhe subjekt i trajtimit më të thellë në këtë Punim Politikash për studimet e doktoratës në shkencat shoqërore dhe humanistike në UP:

- Agjencia e Kosovës për Akreditim ka shërbyer deri më tash më tepër si një mekanizëm për verifikimin formal të plotësisimit të kushteve për studimet doktorale, pa u përqendruar në dimensionet përmbajtësore, si cilësia e personelit akademik dhe e planprogrameve. Vërejtjet kryesore që dolën gjatë analizave kanë të bëjnë me vlerësimin e kompetencave të profesorëve dhe mentorëve në studimet doktorale sa i përket njohjes së gjuhës angleze, apo të gjuhëve të tjera botërore, si dhe të kompetencave të tyre për hulumtim shkencor;
- Kriteret e tashme për pranim në studimet e doktorale janë të pamjaftueshme dhe japin hapësirë për vlerësim jo-objektiv të aplikuesve, gjë që ndikon drejtëpërdrejtë në mundësitë e progresit të tyre në studimet doktorale, si dhe në cilësinë e këtyre studimeve;
- Sfida kryesore e UP-së sa i përket cilësisë së studimeve doktorale është në përcaktimin e standardeve adekuate, ashtu që doktorantët të jenë në gjendje të realizojnë hulumtime të mirëfillta shkencore. Kjo në një masë të madhe do ta ndërprente trendin e hulumtimeve sipërfaqësore pa ndonjë rezultat të mirëfilltë shkencor, apo edhe në nivelin praktik të profesionit për të cilin doktorantët do të duhej të përgatiteshin;
- Krijimi i një raporti mbizotërues të hulumtimit ndaj mësimdhënies do ta mundësonte rritjen e cilësisë së studimeve të doktoratës, meqë profesorët mentorë do të thellonin ekspertizën e tyre për t'i udhëhequr në mënyrë më cilësore përgatitjet e temave të studentëve doktoralë. Në UP nuk ekziston ndonjë prirje institucionale që profesorët e prirur ndaj hulumtimit të lirohen nga obligimet e mësimdhënies, dhe posaçërisht në nivelet më të ulëta, ashtu që të kenë më tepër kohë për t'u përqendruar në aktivitetet e tyre hulumtuese dhe botuese.

Problematika e mësipërme do të trajtohet përmes shqyrtimit të kriterëve të pranimit në studimet doktorale që ofrohen në shkencat sociale dhe humanistike të UP-së, trajtimit të aspekteve të ndryshme të cilësisë së studimeve doktorale, dhe analizimit të resurseve hulumtuese dhe të administrimit të tyre, dhe në fund do të prezantohen konkluzionet dhe rekomandimet për ngritjen e nivelit të cilësisë së studimeve përkatëse doktorale.

Me këtë rast ju shprehim falënderimet tona për kontributin e çmueshëm që e kanë dhënë për këtë hulumtim pjesëmarrësve në intervistat e zhvilluara, profesorëve: Dr. Faton Berishës, Prorektor i UP-së; Dr. Blerim Rexhës, ish-Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë; Dr. Driton Qehajës, Dr. Besnik Krasniqit, Dr. Gazmend Qorrajt, dhe Dekanit të Fakultetit Ekonomik, Dr. But Dedajt; Dr. Enver Hasanit, Dr. Gjuljeta Mushkolajt, Dr. Qerim Qerimit, dhe Dr. Remzije Istrefit; Dr. Blerim Saqipit, Dr. Demë Hotit, Dr. Eda Vulës, Dr. Majlinda Gjellajt; Dr. Agim Hysenit, Dr. Arben Hajdarit, Dr. Bujar Dugollit, Dekan i Fakultetit Filozofik, Dr. Muhamet Malës, Dr. Linda Gusionë; pastaj, z. Besnik Loxhës, Udhëheqës i Zyres për Zhvillim Akademik; si dhe studentëve doktoralë, Mr. Ismet Poterës, Mr. Rajmonda Kurshumliut, Mr. Shqipe Gashit, Mr. Albert Mecinit, Mr. Gëntit Berishës, Mr. Simeana Beshit, dhe Mr. Ruzhdi Berishës, si dhe dy kandidatëve doktoralë që kanë preferuar të mbeten anonimë.

2. SHQYRTIM I KRITEREVE TË PRANIMIT NË STUDIMET E DOKTORATËS

Kriteret për regjistrim në studimet doktorale në UP përfshijnë suksesin në studimet paraprake, interesimin dhe përvojën në kërkimet shkencore, si dhe punimet e botuara dhe rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës. Kriteret për përcaktimin e përparësisë në radhitjen përzgjedhëse janë nota mesatare, aktiviteti kërkimor-shkencor dhe njohja e gjuhës angleze ose e ndonjë gjuhe tjetër botërore. Nota mesatare në studimet themelore dhe ato master vlerësohet me vlerë maksimale prej 40 pikësh, përkatësisht, 20 pikë maksimale për notën mesatare në studimet themelore, dhe 20 pikë maksimale për notën mesatare në studimet master, ku nota mesatare minimale për të dyja këto nivele është 8.00.¹ Në kuadër të kësaj, magjistratura shkencore ose specializimi vlerësohen me 5 pikë.² Aktiviteti kërkimor-shkencor vlerësohet deri në 35 pikë, ku vlerësohen artikujt e botuar në pesë vitet e fundit të indeksuar në *Current Contents*, artikujt e botuar në pesë vitet e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara, artikujt e botuar në pesë vitet e fundit në revistat akademike vendëse (nga UP, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Instituti Albanologjik dhe ai i Historisë), librat universitarë të botuar në pesë vitet e fundit, prezantimet gojore të punimeve në pesë vitet e fundit në tubimet shkencore ndërkombëtare, si dhe prezantimet gojore në tubimet shkencore vendëse.³ Dhe, së fundi, njohuria e gjuhës angleze, ose e një gjuhe të huaj botërore, vlerësohet deri në 20 pikë.⁴ Këtyre kriterëve në praktikë i u është shtuar edhe ai i provimit pranues, që vlerësohet me deri në 20 pikë.⁵

Këto kriteret për pranim në studimet doktorale i konsiderojmë si të pamjaftueshme dhe që krijojnë hapësirë për vlerësim jo-objektiv të aplikuesve, gjë kjo që ka implikime të drejtpërdrejta në cilësinë e këtyre studimeve. Për këtë arsye në punimet e mëparshme është propozuar që njohja e gjuhës angleze të mos jetë kriter vlerësues, por eliminues, për pranim në studimet doktorale, dhe që dokumentimi i njohjes së gjuhës angleze të bëhet përmes testit TOEFL. Këtë

¹ Rregullore për Studimet e Doktoratës të Universitetit të Prishtinës, nr.1/775, të datës 9.9.2014, Neni 7 (4) 1. dhe 2, dhe Vendimi i Senatit të UP të datës 02.9.2016, për plotësim ndryshim të nenit 7, pikës 1, të paragrafit 4 të Rregullores për Studimet e doktoratës nr.1/775, të datës 9.9.2014.

² Rregullore për Studimet e Doktoratës të Universitetit të Prishtinës, nr.1/775, të datës 9.9.2014, Neni 7 (4) 2.

³ *Ibid.*, Neni 7 (4) 3.

⁴ *Ibid.*, Neni 7 (4) 4.

⁵ Intervistë, Bujar Dugolli, Prishtinë, 22 janar 2018.

mangësi përmbajtësore në kriteret e pranimit në studimet doktorale, por edhe në ato master, në ndërkohë e ka adresuar Qeveria e Kosovës me Udhëzimin Administrativ për Gjuhët e Huaja në Programet e Studimit të Ciklit të Dytë apo të Tretë, të 16 marsit 2018, përmes të cilit përcaktohet që aplikantët për këto nivele të studimeve duhet të kenë njohje të gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht), sipas niveleve të Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencave për Gjuhët (CEFRL).⁶ Mirëpo, e metë e këtij Udhëzimi Administrativ është fakti që nivelin e gjuhës që kërkohet si kriter i pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, ky e lë në diskrecion të institucioneve përkatëse të arsimit të lartë.⁷ Për këtë arsye, është e domosdoshme të ndërrohet/amandamentohet Rregullorja e Studimeve të Doktoratës, dhe në të të futet kriter gjuhësor i barabartë për të gjitha programet studimore të niveleve përkatëse. Duke u bazuar në kriteret e CEFRL, për të siguruar studime cilësore doktorale është e nevojshme që aplikantët të kenë të paktën nivelin C1 të kompetencës gjuhësore.⁸

Bazuar në gjetjet dhe analizat e bëra në dy punimet paraprake në kuadër të këtij projekti hulumtues, mund të konsiderohet që kriteri i notës mesatare dhe i aktivitetit kërkimor-shkencor në Rregulloren për Studime të Doktoratës janë përcaktuar ashtu që të krijojnë parakushte për cilësinë e duhur të studimeve doktorale, dhe si të tilla nuk kanë nevojë të ndryshohen/modifikohen. Mirëpo, edhe përkundrejt faktit që provimi pranues si kriter për pranim mund të duket se e dyfishon, ose e devalvon, kriterin e notës mesatare, duke patur parasysh që studimet paraprake mund të jenë kryer në institucione të ndryshme vendore dhe të rajonit, që aplikojnë kriteret të vlerësimit nga më të ndryshmet, ky kriter mund të vazhdojë të zbatohet për të bërë përpjekje për të siguruar cilësinë e kandidatëve doktoralë. Megjithatë, duhet patur parasysh që ky kriter nuk është praktikë për pranim në studimet doktorale në shumicën e universiteteve prestigjioze, dhe, po ashtu, edhe në universitetet e rajonit.

⁶ UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR.03/2018 PËR GJUHËT E HUAJA NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË APO TË TRETË, 16 mars, 2018.

⁷ *Ibid.*, Neni 2, Pika 3.

⁸ CEFRL këtë nivel e përcakton si Nivel i Avancuar i njohjes së gjuhës.

Ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren për Studime të Doktoratës, propozimi i mentorit dhe temës bëhet gjatë vitit të parë të studimeve,⁹ ndërkaq, vlerësimi dhe miratimi i projekt-propozimeve të doktoratës të studentëve bëhet në semestrin e tretë.¹⁰ Rrjedhimisht, studentët doktorale trajtën përfundimtare të këtij projekt-propozimi mund ta japin deri në fundin e semestrit të dytë, ndërkohë që ata në studimet doktorale mund të pranohen edhe pa e patur ndonjë ide të qartë për hulumtimin që planifikojnë ta bëjnë gjatë këtyre studimeve. Kjo ka bërë që gjatë fazës së regjistrimit, së pari, hulumtimi doktorale të lihet anash, dhe, së dyti, që njësitë akademike gjatë kësaj faze të mos e kenë mundësinë për t'i vlerësuar kapacitetet e veta mentoriale për t'i udhëhequr zhvillimet e hulumtimeve doktorale të studentëve përkatës. Prandaj, për t'i eliminuar këto probleme, është e domosdoshme që si kriter i veçantë për regjistrim të shtohet edhe koncept-propozimi i hulumtimit të doktoratës që kandidati doktorale planifikon ta zhvillojë gjatë studimeve të veta. Po ashtu, njësitë akademike përkatëse duhet të obligohen që në konkursin për regjistrim t'i bëjnë të ditura edhe fushat e ngushta shkencore ku kanë kapacitete (ko-) mentoriale, ashtu siç e përcakton edhe Neni 9, Pika 2, e Rregullores për Studimet Doktorale.

⁹ *Rregullore për Studimet e Doktoratës në UP*, Neni 15, Pika 1.

¹⁰ *Ibid.*, Neni 8, Pika 3.

3. SHQYRTIM I CILËSISË SË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Në bazë të Rregullores për Studime të Doktoratës, të drejtë për të udhëhequr kandidatë për doktoratë kanë mësimdhënësit me titujt akademik profesor i rregullt dhe profesor i asocuar, që janë me marrëdhënie të rregullt të punës në UP. Po ashtu, mentor mund të jenë edhe profesorët asistentë që i kanë të botuara të paktën tri punime në revista me recension ndërkombëtar.¹¹ Mirëpo, një pjesë mjaft e madhe e profesorëve që mbajnë titujt përkatës akademikë, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, meqë ata këta tituj i kanë fituar para miratimit të Rregullores në fjalë. Nga ana tjetër, një punim i fund-vitit të kaluar për integritetin akademik të profesorëve në UP duke u bazuar në kriteret formale dhe normat aktuale në fuqi vë në dukje të dhënën që vetëm 28% të profesorëve në UP i plotësojnë kriteret e parashtruara për titujt që i mbajnë. Po ashtu, ky punim e thekson atë që këto kritere më së shumti plotësohen nga profesorët asistentë, ndërkaq më së shumti nuk janë plotësuar nga profesorët e asocuar dhe të rregullt. Ky trend paraqitet edhe lidhur me Fakultetet që janë analizuar në kuadër të këtij hulumtimi, atë Juridik, Ekonomik, Filozofik dhe të Edukimit.¹²

Në thelb të vetin, për sa i përket studimeve doktorale, ky problem është edhe më i thellë, dhe posaçërisht për kategorinë e profesorëve të rregullt, të cilët edhe po t’i plotësojnë kushtet e zgjedhjes në pajtim me Rregulloren e sipërpërmendur për Procedurat Përzgjedhëse, nëse nuk botojnë për një kohë pas zgjedhjes do të dalin nga rrjedhat e hulumtimit shkencor, dhe, rrjedhimisht, nuk do të jenë në gjendje që me sukses të mentorojnë kandidatë doktorale. Prandaj, është e domosdoshme që për sigurimin e cilësisë së studimeve doktorale, kriteret për mentorim të përkufizohen me numrin e punimeve shkencore të botuara në revistat e indeksuara ndërkombëtare, duke u orientuar në ato që janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare

¹¹ *Ibid.*, Neni 9, Pika 1, 2.

¹² ORCA, *Integriteti Akademik i Profesorëve në Universitetin e Prishtinës*, Prishtinë, Dhjetor 2017.

me Recension,¹³ dhe Udhëzimin Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin e Udhëzimit të mëparshëm.¹⁴ Për këtë arsye, nevojitet që të ndërrohet Neni 9 i Rregullores për Studime të Doktoratës, ose që kjo të bëhet me akreditimin e profesorëve për mentorim nga ana e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, dhe kriteri për mentorim që duhet ta plotësojnë mentorët potencial duhet të jetë kushti i botimit i të paktën tri punimeve shkencore në pesë vitet e fundit nga momenti i akreditimit të programit përkatës doktoral, dhe që mentorimi nuk ka nevojë të ndërlidhet me titullin akademik të profesorëve. Këtu duhet theksuar që opcioni i parë, i ndryshimit të kriterëve për mentorim në Rregulloren e Studimeve të Doktoratës së UP-së, e ruan monopolin e UP-së për ofrim të studimeve doktorale në Kosovë, ndërkaq, opcioni i dytë, ai i akreditimit të profesorëve për mentorim nga AKA, ofron mundësi për liberalizimin e arsimit të lartë në Kosovë për ofrimin e studimeve doktorale.

Një nga çështjet e rëndësishme që është diskutuar gjatë tërë hulumtimit, dhe që ka ndikim shumë të madh në cilësinë e studimeve doktorale është ajo e ngarkesës së mentorëve të temave të doktoratës me mësimdhënie në nivelet më të ulëta të studimeve. Duke patur parasysh faktin që me zbatimin e mundshëm të rekomandimeve të sipërpërmendura numri i mentorëve do të zvogëlohej edhe më shumë, është e domosdoshme që ata të shkarkohen në një masë të madhe nga obligimet e mësimdhënies në nivelet Bachelor dhe Master, ashtu që kohën e tyre ta shfrytëzojnë për mentorim sa më cilësor, përfshirë këtu edhe konsultimin e literaturës më të re, përkrahjen e publikimeve të kandidatëve në revistat shkencore ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjen në projekte shkencore, ashtu siç edhe e parasheh Rregullorja për Studime të Doktoratës në UP.¹⁵ Ndërmarrja e këtyre hapave do të mundësonte ngritjen e integritetit akademik dhe të cilësisë së studimeve doktorale, meqë mentorët, pos tjerash, mbajnë përgjegjësi, si etike, ashtu edhe profesionale, për cilësinë e hulumtimeve të kandidatëve doktorale të vlerësuar pozitivisht.¹⁶

Po ashtu, sa i përket bashkë-mentorimit të jashtëm, pos që duhet të plotësohet kushti i sipërpërmendur për botime shkencore ndërkombëtare, me qëllim të rritjes së cilësisë së

¹³ Udhëzim Administrativ MASHT Nr. 01/2018, 19 janar 2018.

¹⁴ Udhëzim Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi –I- MASHT) 7/2018, 23 maj 2018.

¹⁵ Rregullore për Studimet e Doktoratës në UP, Neni 10, Pika 1.

¹⁶ Intervistë, Blerim Rexha, Prishtinë, 24 maj 2018.

studimeve doktorale është e domosdoshme që ko-mentorët të jenë nga universitetet që janë të ranguara dukshëm më lartë se Universiteti i Prishtinës.¹⁷ Për më tepër, duke patur parasysh faktin që Universiteti i Prishtinës është i ranguar më lartë se të gjitha universitetet në rajon ku studimet zhvillohen në gjuhën shqipe, në parim bashkëmentorimi me profesorë nga këto universitete nuk do të sillte ndonjë ngritje të theksuar të cilësisë së studimeve doktorale.

Një ndër parakushtet kyçe për zhvillimin e shkencës në Kosovë, përfshirë këtu edhe studimet e doktoratës, është nevoja urgjente e ndërkombëtarizimit të veprimtarisë shkencore që zhvillohet në Kosovë. Kriteri i botimit i të paktën një punimi shkencor të një pjese të rezultateve të doktoratës në një revistë ndërkombëtare të indeksuar,¹⁸ i paraparë në Rregulloren për Studime të Doktoratës,¹⁹ edhe përkundrejt ankesave për vështirësim të studimeve doktorale, i ka bërë hapat e parë për një ngritje të theksuar të cilësisë së punimeve të doktoratës, për ndërkombëtarizimin e shkencës në Kosovë, dhe për ngritjen e kapaciteteve për publikime ndërkombëtare të kandidatëve doktorale të UP-së.

Mirëpo, plotësimi i vetëm këtij kriteri nuk është i mjaftueshëm për ndërkombëtarizim të plotë të shkencës në Kosovë. Për këtë qëllim, është i domosdoshëm edhe përvetësimi i gjuhës angleze si gjuhë në të cilën do të zhvillohen studimet doktorale, si dhe do të shkruhen tezat e doktoratës në UP.²⁰ Plotësimi i këtij kriteri do të mundësonte, pos tjerash, eliminimin e mundësive për plagjiaturë, përmes aplikimit të softuerëve anti-plagjiat në gjuhën angleze, gjë kjo që duhet të jetë parakusht normativ për lejimin e mbrojtjes së punimeve të doktoratës, pastaj, hapjen e punimeve doktorale të UP-së para opinionit shkencor ndërkombëtar, si dhe mundësinë e ngritjes së cilësisë së studimeve doktorale përmes bashkëmentorimit të jashtëm me profesorë të universiteteve perëndimore me rangim të lartë.

Këtu duhet ri-theksuar që është e domosdoshme që MASHT-i ose UP-ja duhet ta përcaktojë shfrytëzimin e detyrueshëm të softuerit anti-plagjiat për testimin e punimeve doktorale (që duhet të jenë në gjuhën angleze), si dhe ta sigurojnë, si blerjen, ashtu edhe mundësinë e

¹⁷ *Ibid.*

¹⁸ Lista e këtyre revistave është e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ MASHT Nr. 01/2018, 19 janar 2018, dhe Udhëzimin Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi –I- MASHT) 7/2018, 23 maj 2018.

¹⁹ Rregullore për Studimet e Doktoratës në UP, Neni 8, Pika 4, paragrafi 1.

²⁰ Intervista: Faton Berisha, Prishtinë, 23 maj 2018; Blerim Rexha, Prishtinë, 24 maj 2018.

shfrytëzimit, të tyre.²¹ Ndërmarrja e këtyre hapave pa dyshim që do të ngriste rangimin e UP-së në rang-listat e vlerësimit global të universiteteve, si dhe qëndrueshmërinë e programeve doktorale të zhvilluara në bashkëpunim me programin TEMPUS edhe pas përfundimit të tyre.

Nga ana tjetër, Universiteti i Prishtinës deri më tash nuk e ka bërë ndonjë vlerësim të brendshëm të cilësisë së studimeve doktorale dhe të hulumtimeve në nivel të disertacioneve, edhe pse kjo është e përcaktuar me Nenin 21 të Rregullores së Studimeve të Doktoratës.²² Për më tepër, në UP nuk ka ndonjë debat të brendshëm për të vlerësuar se a është punë e mirëfilltë shkencore ajo që bëhet në nivel të disertacioneve.²³ Një shqetësim i theksuar është se mekanizmat për sigurimin dhe mbikëqyrjen e cilësisë UP i ka vetëm në letër, dhe që ata janë jofunksionalë. Nga ana tjetër, bëhet vërejtje që e metë e rëndësishme e Agjencisë së Akreditimit është mungesa e mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të programeve të akredituara doktorale sipas kushteve me të cilat ato janë akredituar.²⁴ Për këto arsye, është e domosdoshme që Këshillat e Studimeve të Doktoratës të Njësive Akadematike dhe Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës, mes tjerash, të merren edhe me vlerësimin e cilësisë së tyre, përfshirë këtu edhe vlerësimin e studentëve doktoralë, gjë që rekomandohet edhe nga ekupe të shumta të ekspertëve ndërkombëtarë për akreditimin e programeve doktorale në UP.²⁵

²¹ Intervistë, Faton Berisha, Prishtinë, 23 maj 2018.

²² Intervista: Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018; Blerim Rexha, Prishtinë, 24 maj 2018; Besnik Loxha, Prishtinë, 25 prill 2018.

²³ Intervistë, Blerim Saqipi, Prishtinë, 9 janar 2018.

²⁴ Intervistë, Besnik Loxha, Prishtinë, 25 prill 2018.

²⁵ Shih p.sh., Raporti Final, 24 qershor 2014, për Akreditimin e Programit Doktoratë në Sociologji, Fakulteti Filozofik, Pika 8.4.6., fq. 12.

4. SHQYRTIM RESURSEVE HULUMTUESE DHE ADMINISTRIMIT TË TYRE

Për nga karakteri i tyre, studimet doktorale dallojnë thelbësisht nga ato bachelor dhe master. Ndërkohë që studimet bachelor dhe master janë, ose plotësisht, ose në masën më të madhe, të orientuara kah përvetësimi i shkencës paraprake nga studentët, studimet doktorale duhet të jenë të orientuara kah krijimi i shkencës së re. E qartë, përvetësimi i shkencës paraprake mund të ndodhë, dhe ndodh edhe në studimet doktorale, mirëpo, orientimi bazik i këtyre studimeve duhet të jetë kah kontributet e reja shkencore. Si të tilla, studimet doktorale cilësore janë të ndërlidhura në thelb me nivelin e kapaciteteve hulumtuese të institucioneve arsimore-shkencore që ato i ofrojnë. Rrjedhimisht, nevojë fundamentale për rritjen e cilësisë së studimeve doktorale në Universitetin e Prishtinës është rritja e kapaciteteve hulumtuese të tij, që deri më tash kanë qenë të kufizuara në përpjekje individuale të personelit të saj akademik, dhe pa ndonjë mbështetje institucionale.

Nga ky aspekt, edhe përkundrejt faktit që në Misionin e vet Universiteti i Prishtinës e ka të theksuar punën kërkimore shkencore, kjo nuk është e reflektuar në buxhetin e tij vjetor që e kap shumën prej 33,834,712 €,²⁶ me ç'rast shumica e mjeteve janë të alokuara për paga dhe mëditje, si dhe për shpenzime kapitale. Në anën tjetër, edhe pse në Planin Strategjik të Universitetit të Prishtinës 2017-2019²⁷ janë të synuara mjete financiare për përkrahjen e aspekteve të ndryshme të hulumtimit me vlerë mbi 200,000 €, këto nuk janë të parapara në buxhetin e Universitetit të Prishtinës. Me fjalë të tjera, mund të konkludohet që është një shpërputhje e plotë midis kësaj Strategjie dhe planifikimit buxhetor të UP-së, dhe që, si pasojë, zbatimi i saj mundet të dështojë fare lehtë.

Kërkesat e profesorëve dhe të studentëve për veprimtari shkencore-hulumtuese mbulohen përmes rialokimeve të buxhetit, me vendime të posaçme të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, pasi nuk ka planifikim buxhetor për veprimtari hulumtuese të UP-së.²⁸ Për më tepër, korniza e tashme normative dhe ligjore e UP-së nuk është e favorshme dhe stimuluese edhe për

²⁶ Ligji Nr. 06/L-020, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, 22 dhjetor 2017.

²⁷ Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës, 2017-2019, 23.12.2016. <https://www.uni-pr.edu/inc/doc/PLANI-STRATEGJIK1.pdf>

²⁸ Intervistë, Faton Berisha, Prishtinë, 23 maj 2018.

veprimtaritë elementare shkencore dhe hulumtuese, meqë ajo në aspektin e vendim-marrjes është e përqendruar në Këshillin Drejtues të Universitetit, në vend që kërkesat për përkrahje të hulumtimeve dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare të shqyrtohen nga njësitë akademike dhe të aprovohen nga Rektori.²⁹

Mirëpo, problemi fundamental i ngecjes së kërkimeve shkencore në UP realisht është mosplanifikimi i hulumtimeve, si nga njësitë akademike, ashtu edhe nga vetë Universiteti.³⁰ Për trajtimin dhe zgjidhjen e këtij problemi është e domosdoshme që në buxhetin e UP-së të ketë linjë të veçantë buxhetore për hulumtim. Këtu njësitë akademike duhet të përgatisin projektet shkencore dhe buxhetet përkatëse në baza vjetore, dhe këto më pas duhet të aprovohen nga Senati dhe Këshilli Drejtues i UP-së dhe të procedohen më tutje në MASHT dhe në Ministrinë e Financave. Një planifikim i tillë, po ashtu do të mundësonte, si themelimin, ashtu edhe funksionalizimin, e instituteve shkencore, krijimi i të cilave është paraparë edhe me Rregulloren përkatëse për institutet shkencore të UP-së.³¹ Për më tepër, për përmirësimin dhe zhvillimin afatgjatë të hulumtimeve shkencore brenda UP-së, është e domosdoshme që njësitë akademike të përgatisin strategji afatgjata të hulumtimit, dhe një strategji e përgjithshme e hulumtimit duhet të përgatitet edhe në nivel të UP-së, për të përmbushur edhe Misionin e tij për kërkime shkencore. Këto strategji hulumtuese duhet ta kenë edhe përkrahjen e mjaftueshme financiare, e cila detyrimisht duhet të reflektohet me linjë të posaçme të buxhetit të UP-së për të mundësuar zbatimin e tyre.

Kështu, aktivitetet hulumtuese të profesorëve të UP-së mbeten më tepër fryt i entuziazmit të tyre individual, se rezultat i hulumtimeve që zhvillohen brenda dhe me mbështetjen e Universitetit të Prishtinës,³² meqë as 0.1% e buxhetit të tij nuk ri-alokohet për hulumtime shkencore.³³

²⁹ Intervistë, Blerim Rexha, Prishtinë, 24 maj 2018.

³⁰ Intervista: Faton Berisha, Prishtinë, 23 maj 2018; Blerim Rexha, Prishtinë, 24 maj 2018.

³¹ Rregullore për themelimin dhe parimin e funksionimit të instituteve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", 25.10.2013.

<https://fxm.uni-pr.edu/getattachment/7ae84808-73e0-40ed-911f-0e644f2306dd/Rregullore-per-themelimin-dhe-parimet-e-funksionim.aspx>

³² Intervistë, Besnik Krasniqi, Prishtinë, 4 shtator 2017.

³³ Intervistë But Dedaj, Prishtinë, 28 gusht, 2017.

Këtu duhet theksuar që *Dokumenti i Bardhë*³⁴ për financimin e qëndrueshëm të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë, për kategorinë e profesorëve të rregullt parasheh që raporti ndërmjet mësimdhënies dhe hulumtimit duhet të anojë kah hulumtimi intenziv, dhe atë me 10% mësimdhënie, 70% hulumtim, dhe 20% shërbime të tjera. Ndërkaq, për kategorinë e profesorëve të asocuar ky raport duhet të jetë 20% mësimdhënie, 60% hulumtim dhe 20% shërbime të tjera. Krijimi i një raporti të tillë në mes të mësimdhënies dhe hulumtimit pa dyshim që do të mundësonte rritjen e vëllimit dhe të cilësisë së punës hulumtuese, dhe, rrjedhimisht, edhe të cilësisë së studimeve doktorale, meqë profesorët mentorë do ta thellonin ekspertizën e tyre për t'i udhëhequr në mënyrë cilësore përgatitjet e temave të studentëve doktorale. Për këtë arsye, është e nevojshme që formulimi eventual i strategjive hulumtuese të njësive akademike dhe strategjisë së përgjithshme të hulumtimit në UP të reflektojë këtë përpjesë midis hulumtimit, mësimdhënies dhe shërbimeve të tjera.

Zhvillimi i kapaciteteve dhe strategjive hulumtuese brenda UP-së do të mundësonte edhe kyçjen e tij në projektet hulumtuese ndërkombëtare që ofrohen edhe nga Korniza e Bashkimit Evropian për Hulumtim dhe Inovacion, Horizon 2020, ku Kosova merr pjesë në cilësinë e Vendit Partner Ndërkombëtar të Bashkëpunimit. Hapi i parë në këtë drejtim është ndërmarrë nga MASHT-i, përmes Rregullores për Përkufizimin dhe Funkcionalizimin e Pikave Kontaktuese Kombëtare të Kosovës për Horizon 2020.³⁵

Marrë në përgjithësi, Universiteti i Prishtinës e ka rregulluar qasjen në bibliotekat elektronike, edhe përkundrejt faktit që pagesa për qasje me vlerë prej 45,000 € është siguruar me rialokim të mjeteve nga linjat e tjera buxhetore.³⁶ Mirëpo, në përcaktimin e platformave të bibliotekave elektronike, Rektorati ka hasur në mospajtimin e njësive akademike nga shkencat shoqërore, që kanë kërkuar qasje në platformën EBSCO. Për të mundësuar një qasje gjithëpërfshirëse bazuar në nevojat konkrete të njësive akademike të veçanta, është e

³⁴ *Dokumenti i bardhë: Modeli financiar për Sistemin e Arsimit të Lartë Publik në Kosovë* (FAITH: Rritja e autonomisë financiare dhe llogaridhënies së institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë), 544142-TEMPUS-1-2013-1-AT-TEMPUS-SMGR.

³⁵ MASHT, Rregullore Nr. 01/2018 për Përkufizimin dhe Funkcionalizimin e Pikave Kontaktuese Kombëtare të Kosovës për Kornizën e Bashkimit Evropian për Hulumtim dhe Inovacion, Horizon 2020, 12.03.2018, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/03/rregullore-horizon-2020-ncp-masht-01-2018-x-copyy.pdf>

³⁶ Intervistë, Faton Berisha, Prishtinë, 23 maj 2018.

domosdoshme që UP-ja të sigurojë qasje në bazë të kërkesave të tyre, dhe që qasja në biblioteka elektronike të mos kufizohet në një platformë të vetme, por të zgjerohet edhe në platforma shtesë që do të plotësonin kërkesat hulumtuese të të gjitha fushave studimore në UP. Sigurimi i një qasjeje të tillë në bibliotekat elektronike do të mundësonte edhe rritjen e cilësisë së studimeve të doktoratit, duke ju ofruar qasje të gjerë studentëve doktoralë në revistat shkencore relevante.

5. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Viteve të fundit Universiteti i Prishtinës, MASHT-i dhe Qeveria e Kosovës, i kanë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm që kanë ndikim në përmirësimin e cilësisë së studimeve doktorale, siç janë: kërkesa për botime në revista të indeksuara ndërkombëtare të një pjese të rezultateve të hulumtimeve doktorale nga kandidatët doktoralë, përcaktimi normativ i platformave të revistave ndërkombëtare për botim, si dhe përcaktimin normativ të muajve të fundit të kriterit të njohjes së gjuhëve të huaja në pajtim me Kornizën e Përbashkët Evropiane të Referencave për Gjuhët për pranimit në studimet e doktoratës. Megjithatë, këto veprime nuk janë të mjaftueshme për sigurimin e cilësisë së studimeve doktorale në UP të nevojshme për të krijuar produkte shkencore të shfrytëzueshme nga komuniteti shkencor vendor dhe ndërkombëtar, derisa hulumtimi në kuadrin e UP-së mbetet edhe më tutje i individualizuar dhe i painstitucionalizuar.

Ndërkombëtarizimi i shkencës që mund të prodhohet në UP, pa dyshim që do të ndikonte në rritjen e rangimit të UP-së në rang-listat vlerësuese të universiteteve botërore, dhe do ta bënte atë atraktiv për studime doktorale edhe nga studentët prej vendeve të tjera. Për t'i përmbushur këto qëllime, rekomandojmë ndërmarrjen e masave të mëposhtme:

1. Si kriter i veçantë për regjistrim në studimet doktorale duhet të shtohet edhe koncept-propozimi i hulumtimit të doktoratës që aplikanti planifikon ta zhvillojë në rast të pranimit;
2. Njësitë akademike përkatëse duhet të obligohen që në konkursin për regjistrim në studimet doktorale t'i bëjnë të ditura edhe fushat e ngushta shkencore ku kanë kapacitete (ko-)mentoriale, ashtu siç e përcakton Neni 9, Pika 2, e Rregullores për Studimet Doktorale;
3. Të amandamentohet Rregullorja e Studimeve të Doktoratës duke e futur në të kriterin gjuhësor të barabartë për të gjitha programet studimore të niveleve përkatëse. Duke u bazuar në kriteret e CEFRL, për sigurimin e studimeve doktorale cilësore është e

nevojshme që aplikantët ta kenë të paktën nivelin C1 të kompetencës gjuhësore, certifikuar nga një institucion kredibil si p.sh. për gjuhë angleze testi TOFEL;

4. Kriteri për mentorim që duhet ta plotësojnë mentorët potencial duhet të jetë ai i botimit të të paktën tri punimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare në pesë vitet e fundit nga momenti i akreditimit të programit përkatës doktoral, dhe që mentorimi nuk ka nevojë të lidhet me titullin akademik të profesorëve. Kjo mund të realizohet përmes ndërrimit të Nenit 9 të Rregullores për Studimet e Doktoratës në UP, ose përmes akreditimit të profesorëve për mentorim nga ana e Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
5. Statuti i UP-së duhet të amendamentohet për të mundësuar shkarkimin në masën më të madhe të profesorëve mentorë nga obligimet e mësimdhënies në nivelet Bachelor dhe Master, ashtu që ata kohën e tyre ta shfrytëzojnë për mentorim sa më cilësor, përfshirë këtu edhe konsultimin e literaturës më të re, përkrahjen e publikimeve të kandidatëve në revistat ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjen në projekte shkencore, ashtu siç edhe e parasheh Rregullorja për Studime të Doktoratës në UP;
6. Me qëllim të rritjes së cilësisë së studimeve doktorale është e domosdoshme që ko-mentorët të jenë nga universitetet që janë të ranguara dukshëm më lartë se Universiteti i Prishtinës;
7. Përmes amendamentimit të Statutit të UP-së, dhe ndryshimeve përkatëse të Rregullores për Studimet e Doktoratës në UP, gjuha angleze duhet të përcaktohet si gjuhë në të cilën do të zhvillohen studimet doktorale, dhe do të shkruhen dhe publikohen tezat e doktoratës;
8. MASHT-i dhe UP duhet ta bëjnë të obligueshëm shfrytëzimin e softuerit anti-plagjiat për testimin e punimeve doktorale (që duhet të jenë në gjuhën angleze), si dhe ta sigurojnë, si blerjen, ashtu edhe mundësinë e shfrytëzimit, të tyre. Kalimi i testit të plagjiaturës duhet të jetë kusht i domosdoshëm për t'u lejuar mbrojtja e punimeve doktorale, dhe ky kriter duhet të përfshihet në Rregulloren për Studime të Doktoratës në UP.

9. Këshillat e Studimeve të Doktoratës të Njësive Akademike dhe Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës, mes tjerash, duhet të merren edhe me vlerësimin e cilësisë së studimeve doktorale përkatëse, përfshirë këtu edhe vlerësimin e studentëve doktoralë;
10. Buxheti i UP-së duhet të ketë linjë të veçantë buxhetore për hulumtim që do të projektohet në bashkëpunim me njësitë akademike, përkatësisht në bazë të projekteve të tyre shkencore dhe projekteve përkatëse buxhetore. Planifikimi i projekteve shkencore do ta mundësonte, si themelimin, ashtu edhe funksionalizimin, e instituteve shkencore në kuadër të njësive akademike;
11. Për përmirësimin dhe zhvillimin afatgjatë të hulumtimeve shkencore brenda UP-së është e domosdoshme që njësitë akademike të përgatisin strategji afatgjata të hulumtimit, dhe që një strategji e përgjithshme e hulumtimit të përgatitet edhe në nivel të UP-së;
12. Për të mundësuar një qasje gjithëpërfshirëse bazuar në nevojat konkrete të njësive akademike të veçanta, është e domosdoshme që UP-ja të sigurojë qasje në bibliotekat elektronike në pajtim me kërkesat e njësive akademike, ashtu që të mundësohet një qasje gjithëpërfshirëse bazuar në nevojat konkrete të atyre njësive, dhe që qasja në biblioteka elektronike të mos kufizohet në një platformë të vetme.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Ky botim është përkrahur nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP), financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).